



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 26 nëntor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Haki Demolli, Mufera Şinik, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Halit Krasniqi dhe Ardian Gjini.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ralph Burche – OSBE, Jeton Bytyçi – OSBE, Etrur Maloku - US Embassy, Isuf Zejna – KDI, Isuf Jahmurataj– MD, Arben Shamolli – ISKP, Rebeka Maliqi, Artan Canhasi – EULEX, Vlora Marmullakaj – EULEX, Lumnije Murati – ZPRK, Lejla Selimi – OSBE, Visar Smajlaj – ekspert, Shkëlzen Gërxhaliu dhe Fahrije Bajrami– praktikantë.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.10.2012;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit të punës në Projektkodin e procedurës penale;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësi;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.10.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.10.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit të punës në Projektkodin e procedurës penale

Behar Selimi – Tha se grupi i punës ka qenë i angazhuar në këtë projektligj për rreth 4 muaj. Në të janë involvuar, si institucionet qeveritare, ashtu edhe ekspertët dhe shoqëria civile. Grupi i punës ka qenë shumë aktiv, për faktin se kanë ardhur propozime gjatë gjithë kohës. Amendamentet kryesisht kanë të bëjnë me gjuhën juridike, ndërsa përmbajtja, cilësia dhe synimi i projektligjit mbetet e njëjta, gjë që mundëson të ruhet kriteri prej 40%, por që edhe nëse kalohet kjo përqindje, atëherë ne mund të zvogëlojmë numrin e amendamenteve, me qëllimin që ligji të procedohet dhe të miratohet sa më parë dhe të hyjë në fuqi më 1 janar 2013.

Kryetari – Vlerësoi se ndryshimet janë shumë të rëndësishme dhe përmbajtjesore dhe grupi i punës ka bërë një punë shumë të mirë. Ai shprehu besimin e tij se Komisioni do t'i kalojë këto amendamente, në mënyrë që nga 1 janari 2013, të mundësohet hyrja në fuqi e Kodit të Procedures Penale dhe Kodit Penal të Kosovës.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, në mënyrë unanime, nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion në Projektkodin e procedurës penale.*
- II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektkodit, me amendamentet e propozuara nga Komisioni.*
- III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.*

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësi

Kryetari – Paraqiti vërejtje në amendamentet: 1, 3, 12, 34, 48, 49,50, 51 dhe 52. Ishte vlerësim i tij se këto amendamente duhet të rishikoheshin. Amendamentet 1 dhe 3, u vlerësuan të panevojshëm, sepse neni 1 i Projektligjit, e ka qartësinë e duhur normative. Po ashtu, vlerësoi se në amendamentin 12, duhet të sqarohen nocionet: “Emergjencë dhe Urgjencë”, sepse këto përkufizime nuk përcaktojnë në shkallë të duhur nocionet që duhet t'i ketë Projektligji për këto dy çështje. Formulimi i amendamentit 34, është i paqartë, sepse nuk e specifikon në mënyrë të duhur çështjen e thirrjes akademike dhe thirrjes shkencore, e që paraqet ngatërrim konceptesh. Amendamentet: 48, 49, 50, 51 dhe 52, nuk janë në pajtim me standardet e hartimit të legjislacionit, sepse nuk është bërë numërimi në pajtim me rregullat e hartimit të legjislacionit. Në vazhdim tha se në amendamentin 51, neni 60, fjalët: “autonom dhe i pavarur” nuk paraqesin formulim adekuat, për t'i dhënë kuptimin normativ kësaj dispozite. Po ashtu, amendamenti 52, titujt: “Drejtimi”, “Kontrolli dhe auditimi” nuk shprehin përmbajtjen normative të këtyre dispozitave.

Albulena Haxhiu – Paraqiti vërejtje në raportin e Komisionit Funksional, lidhur me mospërfshirjen e

amendamenteve, të propozuara nga deputeti Liburn Aliu.

Gëzim Kelmendi – Tek amendamenti 12, dha sqarime për kryetarin e Komisionit, duke thënë se Komisioni për Shëndetësi ka vendosur që në Projektligj, të inkorporohen dy terme: urgjencë dhe emergjencë, për faktin se emergjenca përfshinë intervenimet kur rrezikohet jeta e njeriut, kurse urgjenca përfshinë të gjitha qendrat e mjekësisë familjare.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-125 për shëndetësi dhe amendamentet e propozuara, nuk mund të procedohen për shqyrtim të mëtutjeshëm.
2. I sugjerohet Komisionit Funksional, që t'i rishikojë amendamentet: 1, 3, 12, 34, 48, 49,50, 51 dhe 52.
3. Komisioni paraqet vërejtje në raportin e Komisionit Funksional, lidhur me mospërfshirjen e amendamenteve, të propozuara nga deputeti Liburn Aliu.
4. Raporti me amendamente i kthehen për rishqyrtim Komisionit Funksional, dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij Projektligji, Komisioni kërkon nga Komisioni Funksional, që sa më parë t'i shqyrtojë vërejtjet e paraqitura, në mënyrë që Projektligji të procedohet në seancë plenare, në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave, për institucionet financiare në Kosovë

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave, për institucionet financiare në Kosovë dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave, për institucionet financiare në Kosovë dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Të ndryshme

a. U formua grupi i punës për Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, në këtë përbërje:

Armend Zemaj – kryesues,
Haki Demolli – anëtar,
Behar Selimi – anëtar,
Albulena Haxhiu – anëtare,
Jasmina Zhivkoviq – anëtare.

Ekspertë për ofrimin e mbështetjes së grupit të punës, u caktuan, Rexhep Gashi dhe Visar Smajlaj.

b. Diskutim lidhur me Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Albulena Haxhiu – Në takimin e fundit u diskutua për grupin e punës rreth Ligjit për zgjerimin e kompetencave për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, ligj i cili në seancën plenare është kundërshtuar nga opozita, por që ka kaluar me votat e pozitës. Për këtë ligj është mbajtur edhe një dëgjim publik, ku pjesëmarrës kanë qenë subjektet opozitare dhe shoqëria civile, ku dolën disa konkluzione dhe rekomandime, ndërsa grupi i punës do të duhej të merrej pikërisht me këto çështje. Në takimin e dytë të grupit të punës, kryesuesi u tregua shumë i relaksuar karshi një çështjeje kaq të rëndësishme, prandaj ajo e vlerësoi atë si të papërgjegjshëm. Kur u propozua që ligji të pësojë ndryshim qysh në titull, kryesuesi insistoi që grupi i punës duhet të bëjë vetëm përmirësime teknike, duke zbehur dhe minimizuar kështu punën dhe rëndësinë e Komisionit. Marrë parasysh këto gjëra, Komisioni duhet të koordinohet dhe të ndërmarrë hapa të caktuar, në mënyrë që ky grup i punës të funksionojë në mënyrë të mirëfilltë.

Kryetari – Tha se është konsultuar me kryesuesin dhe ai i ka thënë se në grup të punës, nuk ka pasur mundësi të punohet dhe amendamentohet, prandaj Projektligji do të kthehet edhe njëherë në Komision dhe të merret një vendim. Ne si opozitë nuk e përkrahim Projektligjin, mirëpo partitë në pushtet janë të vendosura ta çojnë çështjen përpara, pasi ata e vlerësojnë se ligji është i mirë dhe i plotëson standardet, prandaj kjo është çështje e perceptimit tonë.

Behar Selimi – Tha se kjo është një agjendë legjislative e Qeverisë dhe tregon përkushtimin e tyre, karshi bashkësisë ndërkombëtare, për luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ai tha se është shumë i interesuar dhe shpreh vullnetin që të hetohet pasuria e secilit zyrtar dhe burimi se prej nga e ka marrë pasurinë, dhe se ai do të përkrahte çdo nismë legjislative nga secili subjekt, i cili do të kishte për qëllim luftimin e kësaj dukurie. Do të duhej që ne si grup i punës, të mblidhemi edhe njëherë dhe të analizojmë Projektligjin, pasi kemi edhe disa amendamente përmbajtjesore nga OSBE, por edhe nga institucione të tjera, prandaj kemi hapësirë për ndryshime dhe do të ishte e rrugës që grupi i punës t'i shqyrtojë këto çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi